Numër: 01- 977 Datë: 13.10.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Rregulloren e Monitorimit Nr. 01/2026 për kriteret dhe procedurat për monitorimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2026 merr:

V E N D I M

I. **Tërhiqet akreditimi** në Intitucionin Austrian Schule i dhënë me Vendimin nr. 01-364, datë 02.05.2025, për kualifikimet e validuara:

i. **Teknik Dentar** - Niveli III dhe IV i KKK, me 180 kredi të AAP dhe
ii. **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë**, Niveli III dhe IV i KKK, me 180 kredi të AAP.

II. Nga marrja e këtij vendimi ndalohet regjistrimi i nxënësve në këto kualifikime.

III. Obligohet institucioni që të ofrojë bashkëpunim me organet përgjegjëse për të garantuar të drejtën e përfundimit të shkollimit në kualifikimin e njëjtë të validuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (tutje IAAP) Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë (tutje ShMLM) "Austrian Schule" ishte akredituar me vendimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve Nr.01-364 datë 02.05.2025 për kualifikimet e validuara:

1. **Teknik Dentar** - Niveli III dhe IV i KKK, me 180 kredi të AAP, dhe
2. **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë**, Niveli III dhe IV i KKK, me 180 kredi, të AAP.

Bazuar në Rregulloren e Monitorimit Nr. 01/2026 për kriteret dhe procedurat për monitorimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Republikën e Kosovës, dokumentacionin e validimit dhe akreditimit, si dhe gjetjet e Inspektoratit të Arsimit të evidentuara në Procesverbalin nr.243/08, datë 14.08.2026, AKK ka realizuar një proces të monitorimit me datë 21.08.2026 në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesiona (IAAP) ShMLM "Austrian Schule".

Ekipi i ekspertëve ka shqyrtuar përmbushjen/pajtueshmërinë e vazhdueshme të përmbushjes së kritereve dhe standardeve të akreditimit nga IAAP SHMLM "Austrian Schule", për kualifikimet *"Teknik Dentar"* dhe *"Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë"*.

Gjatë monitorimit, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se, ndonëse institucioni është i obliguar që të ofroj dëshmi dhe dokumentet relevante, i njëjti nuk ka ofruar dokumentacion dhe dëshmi të mjaftueshme për të mundësuar verifikimin e plotë të vazhdimësisë së kushteve me të cilat është marr vendimi i akreditimit, përfshirë dokumentacionin e stafit mësimdhënës dhe trajnues, evidencat e nxënësve, dokumentacionin pedagogjik dhe administrativ, dëshmitë për realizimin e praktikës profesionale, si dhe dokumentacionin për pajisjet laboratorike dhe hapësirat përkatëse.

- **Për kualifikimin "Teknik Dentar"**; ekipi i ekspertëve ka konstatuar në detaje se:

  - Numri i nxënësve të regjistruar ishte 53, që është në kundërshtim me kuoten e lejuar dhe kapacitetin maksimal të lejuar prej 25 nxënësish, pra janë tejkaluar kuotat e lejuara.
  - Nuk janë paraqitur dëshmi të mjaftueshme për verifikimin e përputhshmërisë së stafit mësimdhënës dhe trajnues me kërkesat e kualifikimit, të disponueshmërisë dhe funksionalitetit të pajisjeve laboratorike, si dhe të organizimit dhe realizimit të praktikës profesionale gjatë periudhës dhjetor 2025 deri me 21.08.2026 kur është realizuar vizita e ekipit të ekspertëve të monitorimit.
  - Janë evidentuar edhe mangësi në dokumentacionin pedagogjik dhe administrativ, si dhe mungesë e dëshmive për gatishmërinë e plotë të hapësirave dhe zbatimin e rekomandimeve të monitorimit paraprak lidhur me ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për mbajtjen e mësimit në ambientet shkollore.

- **Për kualifikimin "Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë"**, ekipi i ekspertëve ka konstatuar në detaje se:

  - Vendimi i akreditimit dhe raporti i validimit përcaktojnë kapacitetin maksimal prej 50 nxënësish për vit shkollor, të organizuar në dy paralele me nga **25 nxënës**. Megjithatë, sipas procesverbalit të Inspektoratit të Arsimit nr. 243/08, gjatë vitit shkollor 2025/2026 në këtë kualifikim ishin regjistruar **65 nxënës** në tri paralele, pra janë tejkaluar kuotat e lejuara si dhe ndarjet në paralele e nxënësve ashtu siç ishte përcaktuar me vendimin për akreditim.
  - Sipas të njëjtit procesverbal, gjatë vitit shkollor 2024/2025 ishin regjistruar 21 nxënës në këtë program para akreditimit dhe licencimit të tij, që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për fushën e akreditimit dhe licensimit të IAAP-së.
  - Për këtë kualifikim, gjatë monitorimit institucioni nuk ka ofruar dëshmi për verifikimin e përputhshmërisë së stafit me kërkesat e programit, të vazhdimësisë së kushteve të laboratorit të shkathtësive klinike dhe të funksionalitetit të pajisjeve për mësimin praktik.
  - Gjithashtu, nuk është dëshmuar realizimi i praktikës profesionale gjatë periudhës dhjetor 2025–21.08.2026 që paraqet obligim ligjor për institucionin ofrues të kualifikimit dhe mospërmbushja e këtij kriteti është mospërmbushj apo shkelje e kushteve esenciale të akreditimit. Dhe shkelja e kushteve të akreditimit ka për pasojë tërheqjen e akreditimit.

Nga deklarimet e përfaqësuesve të institucionit, marrëveshja paraprake për realizimin e praktikës kishte skaduar në dhjetor 2025. Marrëveshja e Mirëkuptimit me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), e datës 21.08.2026, e dorëzuar pas përfundimit të vizitës monitoruese, është marrë në konsideratë

si masë pozitive për organizimin e praktikës në vijim, por megjithatë kishte një shkëputje të gjatë kohore që nuk ishte realizuar praktika në klinikat e paraparë, pra nuk dëshmon realizimin e praktikës gjatë periudhës paraprake (Dhjetor 2025 – Qershor 2026).

Për më tepër, ekipi i ekspertëve të monitorimit gjatë vizitës në raport ka konstatuar se janë evidentuar mangësi në dokumentacionin pedagogjik dhe administrative, dhe se mungon hapësira e nevojshm për fillimin e procesit mësimor.

Ekipi i ekspertëve ka marrë në konsideratë sqarimet e menaxhmentit aktual, sipas të cilave detyra është marrë në maj 2026 dhe dokumentacioni nuk është dorëzuar në tërësi nga menaxhmenti paraprak. Megjithatë, këto sqarime nuk përbëjnë dëshmi të mjaftueshme për përmbushjen e vazhdueshme të standardeve të akreditimit. Po ashtu, raporti paraprak i monitorimit i datës 03.10.2025 kishte evidentuar tejkalimin e numrit të lejuar të nxënësve dhe çështje që lidhen me raportimin e ndryshimeve në menaxhment dhe në stafin mësimdhënës e trajnues. Përsëritja e këtyre çështjeve tregon se rekomandimet e mëparshme nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të akreditimit, verifikimit në terren dhe gjetjeve të Inspektoratit të Arsimit, ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se mospërputhjet e konstatuara për të dy kualifikimet cenojnë kriteret/kushtet themelore të akreditimit, përfshirë (kuotat) kapacitetin e lejuar të nxënësve, dëshmitë për përputhshmërinë e stafit mësimëdhënës, monitorimin e cilësisë, kushtet infrastrukturore dhe laboratorike, realizimin e praktikës profesionale dhe administrimin e dokumentacionit institucional. Të vlerësuara në mënyrë të ndërlidhur, këto mospërputhje nuk mundësojnë konfirmimin e vazhdimësisë së përmbushjes së kritereve dhe standardeve mbi të cilat janë akredituar kualifikimet përkatëse.

Për rrjedhojë, ekipi i ekspertëve i ka rekomanduar Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-364, datë 02.05.2025, lidhur me akreditimin e kualifikimeve "Teknik Dentar" dhe "Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë", me qëllim të vlerësimit të bazës ligjore dhe faktike për revokimin e akreditimit përkatës, në përputhje me kompetencat dhe procedurat ligjore në fuqi.

Gjithashtu, ekipi ka rekomanduar që, në rast të përcaktimit të masave tranzitore për nxënësit, transferimi i tyre të bëhet vetëm brenda kapaciteteve të përcaktuara për kualifikimin përkatës, duke siguruar ruajtjen dhe administrimin e rregullt të dosjeve dhe evidencave të nxënësve deri në përfundimin e vitit shkollor.

AKK pas pranimit të raporteve të monitorim dhe procesverbalit të Inspektoratit të Arsimit të njëjtat i ka vendosur në agjendën e shqyrtimit të Këshillit Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2026.

KD i AKK-së duke ju referuar rrethanave faktike dhe juridike, raporteve të lartëcekura të monitorimit dhe inspektimit, ka konstatuar se bazuar në të dhënat e referuara në këto raporte IAAP SHMI.M "Austrian Schule", ka shkelur kushtet e akreditimit dhe është konstatuar papajtueshmëri të përcaktuara me nenet 17 dhe 18 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare.

Rrjedhimisht bazuar edhe në kompetencat ligjore vendosi që të aplikoj dispozitën e nenit 19 të këtij ligji dhe dispozitat e nenit 23 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime, duke tërhequr akreditimin për kualifikimet "Teknik Dentar" dhe "Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë", në IAAP ShMLM "Austrian Schule", duke vendosur si në dispozitiv.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

- *Austrian Schule*
- *Arkivit të AKK.*
- *MASh*

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve